

20200180325

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR EVIDENCA NË SFERËN E PUNËS

### Neni 1

Në Ligjin për evidenca në sferën e punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 16/2004, 102/2008, 17/11, 166/12 dhe 147/15), neni 56 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit mikro dhe të vogël – person juridik, gjobë në shumë prej 300 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm – person juridik, gjobë në shumë prej 600 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh – person juridik, nëse:

- nuk mban evidencë për punëtorët e punësuar, në pajtim me nenin 7 të këtij ligji,
- nuk mban evidencë për nevojën për punëtorë, në pajtim me nenin 12 të këtij ligji,
- nuk mban evidencë për rroga, në pajtim me nenin 20 të këtij ligji,
- në evidencat për lëndime të punëtorëve gjatë punës, nuk i fut të dhënat e nevojshme, në pajtim me nenin 23 të këtij ligji,
- nuk mban evidencë për grevë, në pajtim me ligjin dhe nuk e dorëzon në sindikatë dhe Entin Shtetëror për Statistikë, në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, dhe
- nuk mban evidencë për shfrytëzues të të drejtave nga sigurimi invalidor dhe nuk fut të dhëna për invalidin e punës në bazë të aftësisë së mbetur të punës dhe nuk fut të dhëna për aftësi të ndryshuar të punës ose rrezik të drejtpërdrejtë nga ndodhja e invaliditetit (neni 49 i këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 80 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik të punëdhënësit mikro dhe të vogël, gjobë në shumë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 250 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.“.

### Neni 2

Neni 57 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 150 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje punëdhënësit mikro dhe të vogël – person juridik, gjobë në shumë prej 250 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm – person juridik, gjobë në shumë prej 600 deri 800 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh – person juridik nëse:

- nuk mban evidencë për lëndime në punë ose nuk i fut të dhënat për lëndime në afatin e përcaktuar me ligj (neni 24 i këtij ligji),
- në afatin e përcaktuar nuk e dorëzon fletëparaqitjen nga nenet 16, 31, 32 dhe 41 të këtij ligji,
- nuk dorëzon fletëparaqitje dhe çregjistrim ose të njëjtën e dorëzon pas kalimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenet 16, 31 dhe 32 nën b) të këtij ligji),
- në fletëparaqitje nga nenet 13, 31 dhe 32 nën b) dhe 40 të këtij ligji, nuk janë futur të dhëna të sakta dhe
- të dhënat nuk janë regjistruar në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj (neni 51 i këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 30 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik të punëdhënësit mikro dhe të vogël, gjobë në shumë prej 100 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë të punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Gjobë në shumë prej 100 deri 150 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni do t’i shqiptohet personit zyrtar në personin juridik.

(5) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.“.

### Neni 3

Neni 57-a ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse:

- nuk paraqet ndryshim të të dhënave të regjistruara në evidencën nga nenet 11 dhe 19 të këtij ligji,

- nëpërmjet deklaratës paraqet të dhëna të pasakta ose ndryshimin e të dhënave nuk e paraqet në afatin ligjor (nenet 11 dhe 19 të këtij ligji),

- jep deklarata me të dhëna të pasakta nga dokument publik ose dokument tjetër, për regjistrim në evidencë (neni 51 paragrafi (2) i këtij ligji) ose

- largohet për punë në vend të huaj, ndërsa pas kthimit nuk paraqitet në afatin ligjor në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 32 pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji).

(2) Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar nëse:

- nuk mban evidencë për person të papunësuar në pajtim me ligjin (neni 18 i këtij ligji),

- ndryshimin e të dhënave nuk e zbaton në pajtim me ndryshimin e paraqitur (neni 19 i këtij ligji) ose

- fut të dhëna të pasakta në evidencë (neni 52 paragrafi (4) i këtij ligji).

(3) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.“

### Neni 4

Neni 57-b ndryshohet si vijon:

“(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës konstaton se punëdhënësi përkatësisht drejtori, personi përgjegjës ose personi tjetër zyrtar te punëdhënësi ka bërë kundërvajtje të përcaktuar në nenet 56 dhe 57 të këtij ligji, është i detyruar për kundërvajtjen e bërë të përpilojë procesverbal në pajtim me ligjin dhe me aktvendim të punëdhënësit përkatësisht drejtorit, personit përgjegjës ose personit tjetër zyrtar te punëdhënësi t’i shqiptojë masë inspektuese vërejtje dhe t’i përcaktojë afat në të cilin është i detyruar t’i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara.

(2) Nëse pas kalimit të afatit të përcaktuar gjatë shqiptimit të vërejtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i punës përcakton se parregullsitë dhe mangësitë ende nuk janë mënjeluar, me aktvendim shqipton urdher për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive të përcaktuara.

(3) Aktvendimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, miratohet menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit në pajtim me ligj.

(4) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk janë përcaktuar parregullsi dhe shlekje tjera të ligjit ose rregullës tjetër ose parregullsitë e përcaktuara janë mënjeluar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i punës e ndërpret procedurën, me konstatim në procesverbal në pajtim me ligjin.

(5) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, inspektori i punës mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të theksuar në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(6) Në rastin nga paragrafi (4) i këtij neni, inspektori i punës është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditësh, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese, në pajtim me ligjin.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, te organi kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligjin.

(8) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni.

(9) Për vërejtjet e shqiptuara Inspektorati Shtetëror i Punës mban evidencë, në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.“.

#### Neni 5

Neni 57-v ndryshohet si vijon:

“(1) Organ kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese të dispozitave të këtij ligji është Inspektorati Shtetëror i Punës.

(2) Inspektori i punës, para se të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje nga nenet 56 dhe 57 të këtij ligji, është i detyruar që personit përgjegjës ose personit të autorizuar nga ai të punëdhënësi t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(3) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e lëshimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, e nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar zyrtar do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

(4) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse i përcakton ministri kompetent për çështje nga sfera e punës.“.

#### Neni 6

Neni 58 shlyhet.

#### Neni 7

Në tërë tekstin e Ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

#### Neni 8

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 9

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për evidenca në sferën e punës.

#### Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.